



17 tetor, 2023

KOMUNIKATË

Seanca e dhjetë (X) e Bordit të ZRRE

Sot, më 17 tetor 2023, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur seancën e dhjetë me radhë për këtë vit.

Në këtë seancë, Bordi ka marrë vendim për miratimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Strukturën Tarifore për Tarifat e Energjisë Termike të ndërmarrjes NQ Termokos për sezonin 2023/2024.

Bordi ka vendosur që tarifat e energjisë termike për këtë sezon ngrohëse të mbesin të njëjta me tarifat e vitit paraprak.

Po ashtu në këtë seancë Bordi ka miratuar aneks marrëveshjen të lidhur ndërmjet KEK dhe NQ Termokos për përcaktimin e çmimit të energjisë termike për furnizim me ngrohje;

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe disa ankesa të konsumatorëve dhe çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e sektorit si dhe të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE www.ero-ks.org.